

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	"Nuk kam më asgjë në shtëpi"/ Nëna kërkon ndihmë për djalën 13-vjeçar: "S'kemi as bukë, as ujë"
ADRESA	https://joq-albania.com/artikull/1392360.html
BURIMI	joq-albania.com
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	17 shtator 2026, 21:02:18 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
LEXUAR NGA FAQJA	17 shtator 2026, 20:46:00 UTC <i>Portali nuk e deklaroi datën në asnjë formë makinë-lexueshme; kjo është ora e shkruar për njeriun, e lexuar nga faqja me meto dën text_date. Dritarja: 17 shtator 2026, 20:45:00 UTC → 17 shtator 2026, 20:47:00 UTC. Kalon nga një rregull i yni që mund t ë gabojë, prandaj shfaqet si e lexuar dhe jo si e deklaruar.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	6143f66953ba801e6d2326f428fb2452193498e279a68a5f3ff517a0d7916f25
TEKSTI	06312adf90c1304187885f2c84d6bacd232fddbb6b28e3a0bd1b9ae18604fd29
PAMJA	8a95fb1a3c34b3f6e96f43a9419502b69a3aa942a479e7bf6eed12b91198d7ba

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	09936eac57b38f45c4be1785f7416c7d0762af77d1f80e1b78b7455c72d918d1
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	3b121f0f38f9983afad61fe399871208f196860b9a8965bfd896e6b91a545c4e
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/09936eac57b38f45c4be1785f7416c7d0762af77d1f80e1b78b7455c72d918d1>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

“Nuk kam më asgjë në shtëpi”/ Nëna kërkon ndihmë për djalin 13-vjeçar: “S’kemi as bukë, as ujë”

Shkruar nga: Y Pepa | Publikuar më: 17.09.2026, 22:46



Share



Share



Një nënë e vetme i është drejtuar redaksisë së **JOQ Albania** për të kërkuar ndihmë urgjente për djalin e saj 13-vjeçar, i cili, sipas saj, përballet me një çrregullim të spektrit të autizmit dhe ka nevojë për trajtim dhe mbështetje të vazhdueshme.

Nëna tregon se jeton vetëm me djalin dhe është e papunë. Sipas saj, djali është shtruar dy herë në spital, por pas daljes gjendja e tij përkeqësohet sërish.

Ajo thotë se djali ka nevojë për **terapi, psikolog dhe një strukturë të përshtatshme ku të mund të trajtohet dhe aktivizohet**, pasi është izoluar në shtëpi dhe nuk pranon të shkojë në shkollë.

Sipas saj, pavarësisht kërkesave të bëra, **Shërbimet Sociale nuk kanë marrë përsipër t’i sigurojnë këto shërbime**.

“Djalit i duhet terapi, shkollë, por nuk bindet të shkojë. Nuk më kanë ofruar këto të Sociale. Duhet të vijë një psikolog ta bindë për të dalë nga shtëpia dhe duhet të ma sigurojnë këto të Sociale. Megjithatë ju kam kërkuar, nuk ma ofrojnë.”

Në pamjet e dërguara në redaksi shihen kushtet e vështira në banesë. Nëna tregon se djali ka dëmtuar mobiliat dhe pajisjet e shtëpisë, ndërsa familja tashmë ka mbetur edhe pa disa prej sendeve bazë.

Ajo thotë se nuk ka mundësi ekonomike për t’i zëvendësuar ato dhe se nuk mund të punojë, pasi duhet të qëndrojë vazhdimisht me djalin.


Apeli i saj është i drejtpërdrejtë: **kërkon ushqime, ujë, ndihmë monetare, pastrim dhe higjienizim të banesës**, si dhe ndihmë për të zëvendësuar mobiliat e dëmtuara.

“Nuk kam lek për ujë as bukë. Të më ndihmojnë të zëvendësoj mobiljet. Një ndihmë me pastrim shtëpie, ndihmë monetare. Çdo lloj ndihme kam nevojë.”

Nëna shprehet se aktualisht të ardhurat e vetme që merr janë pagesat e djalit nga **KEMP-i**, të cilat, sipas saj, dalin pas datës 25, duke e lënë familjen pa mundësi për të përballuar nevojat bazë deri atëherë.

Ajo kërkon gjithashtu që institucionet të ndërhyjnë për të gjetur një zgjidhje të qëndrueshme për trajtimin dhe aktivizimin e djalit.

JOQ Albania publikon apelin e nënës me shpresën që qytetarët të ndihmojnë familjen me ushqime, ujë dhe nevojat e tjera bazë, ndërsa kërkon nga **Shërbimet Sociale dhe institucionet përrejtëse** të verifikojnë rastin dhe të




Më të Lexuarat



ARTIKULL JOETIK?

ofrojnë mbështetjen e nevojshme.

Për ndihmë/kontakt: 069 565 9279



FACT CHECK: Synimi i JOQ Albania është t'i paraqesë lajmet në mënyrë të saktë dhe të drejtë. Nëse ju shikoni diçka që nuk shkon, jeni të lutur të na e **raportoni këtu**.

JOQ Sondazh
KLIKO PËR TË VOTUAR

TË NGJASHME

Më të fundit



Dërgo materialin tënd këtu >

Puno me ne! Marketing Politika e privatësisë Rreth Nesh Kushtet e përdorimit Kontakt

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.